

Një mollë e re shërri: KOS-i në dialogun për normalizim

Qershor
2022



1.

Asociacioni i Komunave Serbe në Limbon e Marrëveshjeve të Papërbushura

2.

Loja e numrave: Zgjidhja e çështjes së personave të zhdukur 20 vjet më vonë

3.

Një tjetër mollë sherri: KOS në Dialogun për Normalizimin e marrëdhënieve

4.

Furnizimi me energji elektrike në veri të Kosovës

5.

Privatizimi në Kosovë nga këndvështrimi i komunitetit Serb

6.

Liria e lëvizjes: Episoda stiker

Titulli i hulumtimit: Një mollë e re shërri: KOS-i në dialogun për normalizim

Botues: Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur – KFOS

Për botuesin: Iniciativa e Re Sociale

Autore: Milica Andrić Rakić

Gjuha origjinale në të cilën është hartuar analiza është gjuha serbe.

Lektura: Trankos

Dizajn: tedel

Shtypshkronja (Tirazhi): 80

Ky publikim është hartuar në kuadër të projektit OPEN, të implementuar nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS), në bashkëpunim me Iniciativën e Re Sociale. Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e KFOS-it.

Viti i publikimit: Qershor 2022

PËRMBAJTJA

Rreth Nismës Open 7

01.

HYRJE 10

02.

CILA DO TË ISHTE
TEMA? 11

03.

FORMA E
MARRËVESHJES 13

04.

ARGUMENTET
PËR DHE KUNDËR
PËRFSHIRJES SË
PËRFAQËSUESVE
TË KISHËS NË
BISEDIMET
EVENTUALE PËR
STATUSIN E KOS-IT 14

Opsioni 1:

PËRFSHIRJA 17
DIREKTE E
PËRFAQËSUESVE
TË KOS-IT NË
DIALOGUN NË MES
TË BEOGRADIT DHE
PRISHTINËS

Opsioni 2:

PËRFSHIRJA 18
INDREKTE E
PËRFAQËSUESVE
TË KOS-IT NË
DIALOGUN NË MES
TË BEOGRADIT DHE
PRISHTINËS

Opsioni 3:

PËRJASHTIMI I
PLOTË I TEMËS
SË KOS-IT NGA
MARRËVESHJA PËR
NORMALIZIMIN E
MARRËDHËNIEVE 19

05.

PËRFUNDIM 20

Rreth Nismës Open

“Demokracia, haptësia dhe perspektivat e komunitetit serb në Kosovë – OPEN” është nismë e Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS), që ka filluar gjatë vitit 2020. Kjo nismë ka për qëllim të zhvillojë hapësirë të hapur e dinamike për diskutime brenda dhe mes komunitetit serb dhe komuniteteve të tjera si dhe me institucionet e Kosovës.

Organizatave të shoqërisë civile nga komuniteti serb në Kosovë, anëtare të nismës, merren specifikisht me analiza dhe vlerësime të ndikimit të organizatave civile e politike në zhvillimin e demokracisë, si dhe në haptësinë e komunitetit serb në Kosovë. Me këto analiza vlerësohet haptësia e institucioneve, politikave publike dhe proceseve të rëndësishme karshi komunitetit serb në Kosovë, si dhe niveli i haptësisë së komunitetit serb karshi tyre.

Këto analiza do të ndihmojnë të pasqyrohet gjendja aktuale dhe perspektivat e komunitetit serb në Kosovë, duke shërbyer njëkohësisht edhe si bazë për përfaqësimin e argumentuar të orientuar drejt vendimmarrësve, institucioneve të pushtetit lokal e qendror, si dhe bashkësisë ndërkombëtare.

Qëllimi i studimit dhe metodologjia e hulumtimit

Qëllimi i përgjithshëm i hulumtimit është të shqyrtojë mundësinë e përfshirjes së statusit të Kishës Ortodokse Serbe në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës dhe pranueshmërinë e modeleve të ndryshme të pjesëmarrjes së mundshme të përfaqësuesve të kishës në negociatat për komunitetet e Serbëve të Kosovës dhe Shqiptarëve të Kosovës.

Qëllimi specifik i hulumtimit është të përcaktojë rëndësinë e përfshirjes së Kishës Ortodokse Serbe në dialogun për normalizim për pranimin e një marrëveshjeje të mundshme në opinionin serb.

Koha:

Hulumtimi është zhvilluar në periudhën dhjetor 2021 – shkurt 2022.

Metodologjia dhe dizajni i hulumtimit kualitativ

Analiza e përmbajtjes, e cila përfshinte njoftimet dhe deklaratat e zyrtarëve të kishës dhe zyrtarëve të Kosovës, dha një pasqyrë të cilësisë së marrëdhënieve dhe retorikën e të dyja palëve, ndërsa analiza e përmbajtjes, e cila përfshin ligjet, aktvendimet gjyqësore dhe raportet e institucioneve, paraqet gjendjen faktike lidhur me pronën e Kishës Ortodokse Serbe që gjendet në Kosovë.

Nëpërmjet 5 intervistave të pa strukturuara me historianë, përfaqësues politikë dhe ndërkombëtarë dhe burime të afërta me KOS-in, u përcaktua historia e pjesëmarrjes së përfaqësuesve të KOS-it në negociatat me shqiptarët e Kosovës dhe komunitetin ndërkombëtar, por edhe roli i tyre në organizimin e jetës së pasluftës së komunitetit Serb të Kosovës. Intervistat janë mbajtur në mes të muajit janar dhe shkurt 2022.

Përmes një tryeze të rrumbullakët me 10 ekspertë të të drejtës ndërkombëtare, shkencave politike, komunikimit, por edhe gazetarëve, u përcaktuan modelet e mundshme për arritjen e një marrëveshjeje, e cila do të përfshinte një kapitull për Kishën Ortodokse Serbe, por edhe aspekte jo atraktive të një marrëveshjeje të tillë për publikun serb, përkatësisht për publikun shqiptar. Tryeza e rrumbullakët u organizua në shkurt 2022.

Hulumtimi ka përfshirë dy fokus grupe me gjithsej 17 qytetarë të komunitetit serb dhe komuniteteve të tjera joshumicë. Fokus grupet u zhvilluan midis 25 dhe 28 janar.

1. Hyrje

Në mesin e vitit 2021, zëvendëskryeministri i ngarkuar për dialogun me Serbinë, Besnik Bislimi, prezantoi në Kuvendin e Kosovës një raport për dialogun për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, në të cilin u theksua se në pjesën e dytë të vitit 2020, Qeveria e Avdullah Hotit me palën serbe është dakorduar që të bisedojë për 8 tema. Në listën e temave është edhe "statusi i Kishës Ortodokse Serbe" (KOS). Nuk kishte konfirmime të tjera zyrtare se kjo temë ishte në dhomën e pritjes në Bruksel, por në mesin e vitit 2021 u mbajt një takim zyrtar¹ midis të dërguarit të posaçëm të BE-së për dialogun Beograd-Prishtinë dhe çështje të tjera rajonale në Ballkanin Perëndimor dhe Emisarit të atëhershëm special të Stejt Departamentit për Ballkanin Perëndimor Matthew Palmer me Patriarkun e Kishës Ortodokse Serbe, Porfirin. Siç theksoi Lajçak në "në takimin e parë", u diskutua për nevojën e një pozicioni të veçantë të Kishës Ortodokse Serbe dhe pronës së saj në Kosovë.

Mundësia e përfshirjes së kësaj teme në dialog dhe mënyrat se si mund të bëhet kjo janë temat kryesore të këtij hulumtimi, në të cilin kanë marrë pjesë dhjetëra ekspertë - juristë, historianë, komunikues, politologë, gazetarë - përmes intervistave, tryezave të ekspertëve dhe dy fokus grupe, përfaqësues politik, burime të afërta me Kishën ortodokse serbe, por edhe qytetarë. Cili mund të jetë rezultati i negociatave të

mundshme që do t'i referoheshin Kishës Ortodokse Serbe nuk është tema e këtij raporti.

Derisa për palën serbe, përfshirja e kësaj teme në një marrëveshje të mundshme gjithëpërfshirëse për normalizimin e marrëdhënieve është plotësisht e pritshme, madje kyçe për pranueshmërinë e marrëveshjes, për shqiptarët e Kosovës kjo çështje është përfshirë në Aneksin V të Propozimit Gjithëpërfshirës për Statusin e Kosovës². (Plani i Ahtisaarit).

Ekziston një pajtueshmëri e pjesshme në qëndrimin e të dy palëve vetëm në vlerësimin se kuadri ligjor ekzistues nuk po zbatohet në mënyrë adekuate. Megjithatë, derisa pala serbe pretendon se kjo ndodh për shkak të mosgatishmërisë së institucioneve, Qeverisë së Kosovës për t'i trajtuar qytetarët serbë në mënyrë të barabartë, të anketuarit shqiptarë e shohin problemin në refuzimin e qytetarëve dhe përfaqësuesve të Dioqezës së Rashkës dhe Prizrenit (ERP) për të pranuar pavarësinë e Kosovës. Nëse negociatat për Kishën Ortodokse Serbe zhvillohen në kuadër të dialogut për normalizim, pjesëmarrja e përfaqësuesve të kishës nënkuptohe për palën serbe, por vetëm në mënyrë indirekte.

¹ Objava na Tviteru, zvaničan nalog Miroslava Lajčaka, 4. jun 2021: <https://twitter.com/MiroslavLajcak/status/1400853103205888003?s=20&t=3HElGfzYfWu-lvgTy9PzVA>

² Zyra e Kombeve të Bashkuara për Koordinimin e Çështjeve Humanitare, *Comprehensive Proposal for the Kosovo Status Settlement*, 26. mars 2007: <https://reliefweb.int/sites/reliefweb.int/files/resources/1DC6B184D02567D1852572AA00716AF7-Full-Report.pdf>

2. Cila do të ishte tema?

Sipas burimeve pranë KOS-it, për përfaqësuesit e Dioqezës së Rashkës dhe Prizrenit, përfshirja e statusit të KOS-it në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, do të thotë mundësi për të bërë kërkesa kryesisht në lidhje me pronën. Pika fillestare e negociatave do të ishte zbatimi arbitrar i Aneksit V të Planit të Ahtisaarit, për të cilin ERP shpesh thekson se nuk është plotësisht i integruar në sistemin ligjor të Kosovës³. Kërkesat e tjera do të përfshijnë garancitë shtesë se autoritetet e Kosovës nuk do të jenë në gjendje ta tjetërsojnë pronën e KOS-it, të ndryshojnë identitetin e saj, të vendosin për të në mënyrë të pavarur ose të prishin jetën e komuniteteve të murgjve dhe klerikëve⁴, por edhe restaurimin e pronës së konfiskuar me Ligjin agrar të vitit 1946 dhe kthimin e pronës së uzurpuar.

Në anën tjetër, burimet e afërta me Avdullah Hotin, theksojnë se letra tematike e Qeverisë së Kosovës së atëhershme, që kishte të bënte me çështjen e KOS-t në dialog, ka parashikuar vetëm mundësinë e forcimit të kapaciteteve institucionale për zbatimin e kornizës juridike mentale, në thelb të cilës është Ligji për zonat

³ Dioqeza e Rashkës – Prizrenit, Komunikatë e Episkopit të Rashkës- Prizrenit *Teodosija me rastin e kandidimit të Prishtinës për anëtarësim në UNESCO dhe deklaratat e z. Petrit Selimij*, 16. tetor 2015: <https://eparhija-prizren.com/sr/saopstenja/saopstenje-episkopa-rasko-prizrenskog-teodosija-povodom-kandidature-pristine-za-clanstvo/>

⁴ Dispozitat që kanë të bëjnë me statusin e diskrecioni i plotë i KOS-it për menaxhimin e objekteve shpirtërore që janë në pronë të saj, disa prej tyre, sipas përfaqësuesve të KOS-t, nuk janë parashikuar në mënyrë adekuate në kornizën juridike të Kosovës.

e veçanta të mbrojtura⁵. Me fjalë të tjera, ata e shihnin problemin në një kornizë institucionale të pazhvilluar, jo në statusin e Kishës Ortodokse Serbe.

Qeveria e Avdullah Hotit tregoi një tendencë për të përfshirë çështjen e pronës së KOS-it në dialogun me Beogradin, madje edhe marrëveshjen, në shtator të vitit 2020, kur në 13 nga 17 pikat e Marrëveshjes për Normalizimin Ekonomik, të nënshkruar në Shtëpinë e Bardhë, në prani të presidentit të atëhershëm të SHBA-së, Donald Trump, u obligua të "zbatojë vendimet gjyqësore që kanë të bëjnë me Kishën Ortodokse Serbe". Mirëpo, fakti se zbatimi i vendimeve të plotfuqishme gjyqësore është temë e dialogut dhe tregtisë ndërmjet dy palëve, për komunitetin serb të Kosovës përkthehet në paralajmërim se sistemi i drejtësisë i Kosovës nuk do t'i trajtojë ato në mënyrë të barabartë.

Përveç mungesës së vullnetit politik për negociatë për statusin e Kishës Ortodokse Serbe, qytetarët në fokus grupe theksojnë perceptimin e tyre se qeveria aktuale e Kosovës e ka "radikalizuar qëndrimin e saj ndaj Serbëve, madje edhe ndaj kishës". Për dallim nga periudha e pasluftës, kur kishte kontakte dhe bisedime ndërmjet përfaqësuesve serbë, duke përfshirë përfaqësues të kishës dhe shqiptarëve, "tani klima për dialog është më e keqe se pas luftës", tha një anëtar i Koalicionit Kthimi. Marrëdhëniet ndërmjet

⁵ Gazeta Zyrtare e Kosovës, *Ligji 03/L-039 për Ligjin për zonat e veçanta të mbrojtura*, 4. qershor 2008: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2529>

Qeverisë së Kosovës dhe DRP-së kanë vite që po përkeqësohen ngadalë, më e dukshme në opinion por edhe në bashkësinë ndërkombëtare është mosmarrëveshja lidhur me refuzimin e autoriteteve lokale dhe qendrore për të zbatuar vendimet gjyqësore për pronën e KOS-it. Kjo u përshkallëzua kur me vendimin e organizatave për ruajtjen e trashëgimisë kulturore, Europa Nostra, Manastiri i Deçanit u përfshi në listën e “7 monumenteve kulturore më të rrezikuara të Evropës 2021” për shkak të pasigurisë juridike.⁶ Ky vendim ka shkaktuar reagime të ashpra të Qeverisë së Kosovës, e cila ka protestuar duke iu drejtuar kësaj organizate⁷, duke demantuar nevojën për këtë vendim. Gjithashtu, tre liderë institucional, kryeministri, presidentja dhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, njëkohësisht në të njëjtën periudhë kërkuan nga UNESCO⁸ që nga lista e trashëgimisë botërore të rrezikuar të hiqen katër manastire të Kishës Ortodokse Serbe, që gjenden në Kosovë. Përfaqësuesit e KOS-it momentalisht refuzojnë⁹ që të takohen me zyrtarët e Kosovës derisa të zbatohet vendimi i gjykatës që konfirmon pronësinë e KOS-it mbi tokën në Deçan.



Përveç mungesës së vullnetit politik për negociata për statusin e Kishës Ortodokse Serbe, qytetarët në fokus grupe theksojnë perceptimin e tyre se qeveria aktuale e Kosovës e ka “radikalizuar qëndrimin e saj ndaj Serbëve, madje edhe ndaj kishës”. Për dallim nga periudha e pasluftës, kur kishte kontakte dhe bisedime ndërmjet përfaqësuesve serbë, duke përfshirë përfaqësues të kishës dhe shqiptarëve, “tani klima për dialog është më e keqe se pas luftës”, tha një anëtar i Koalicionit Kthimi.

6 Europa Nostra, *7 Most Endangered*, Deçan Monastery, 08. prill 2021: <https://7mostendangered.eu/sites/decani-monastery-kosovo/>

7 KoSsev, *Kurti and Osmani in a letter to Europa Nostra before the final decision on Decani: Churches in Kosovo are not endangered*, 9. april 2021: <https://kossev.info/kurti-and-osmani-in-a-letter-to-europa-nostra-before-the-final-decision-on-decani-churches-in-kosovo-are-not-endangered/>

8 KoSsev, *Kurti, Osmani, Konjufca wrote to UNESCO to remove 4 monasteries from the list of endangered and that Serbia is not responsible for them*, 22. maj 2021: <https://kossev.info/kurti-osmani-konjufca-wrote-to-unesco-to-remove-4-monasteries-from-the-list-of-endangered-and-that-serbia-is-not-responsible-for-them/>

9 Srpska pravoslavna crkva, *Saopštenje za javnost Eparhije raško-prizrenske*, 6. februar 2022: http://www.spc.rs/sr/saopshenje_za_javnost_eparhije_rashkoprizrenske_14

3. Forma e marrëveshjes

Politologët dhe ekspertët e së drejtës ndërkombëtare pajtohen se, nëse arrihet një marrëveshje për normalizimin gjithëpërfshirës të marrëdhënieve, duhet të pritet një marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Serbisë dhe Qeverisë së Kosovës, e cila do të ratifikohej nga kuventet dhe më pas do të zbatohet brenda të dy sistemeve juridike. Në atë rast është reale të priten garanci të caktuara ndërkombëtare, sidomos për aktgjykime që aktualisht nuk janë në zbatim, thotë njohësi i së drejtës ndërkombëtare dhe shton se duhet pasur parasysh se “nga pikëpamja juridike ndërkombëtare, një palë kontraktuese nuk mund të thirret në normat juridike vendase nëse nuk respekton detyrimet ndërkombëtare. Në këtë rast, është reale të priten edhe garancitë e caktuara ndërkombëtare, veçanërisht për aktgjykimet që momentalisht nuk zbatohen, thekson eksperti i të drejtës ndërkombëtare dhe shton se duhet të kemi parasysh “që nga pikëpamja ndërkombëtare-juridike, pala kontraktuese nuk mund të bazohet në norma të brendshme juridike në qoftë se nuk respekton obligimet ndërkombëtare.”

Zbatimi i dispozitave për Asociacionin e Komunave Serbe në Kosovë u bllokua pasi Gjykata Kushtetuese vlerësoi se marrëveshja është obligim ndërkombëtar, që duhet të zbatohet, por disa pjesë të kësaj marrëveshjeje nuk janë në përputhje me Kushtetutën e Kosovës. I pyetur nëse dispozita për domosdoshmërinë e ndryshimit të kushtetutës së të gjitha palëve mund të jetë element i një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse, eksperti i së drejtës

ndërkombëtare theksoi se nuk do të ishte logjike. “Supozimi është se negociatorët nuk do të shkelin me vetëdije kushtetutën me nënshkrimin e marrëveshjes. Në këtë situatë, do të ishte e nevojshme që fillimisht të ndryshohen kushtetutat për të arritur një marrëveshje. Negociatorët i obligon kushtetuta e tyre, por e drejta ndërkombëtare, përveç disa situatave ekstreme, nuk hyn fare në të dhe vlerëson se detyrimi juridik ndërkombëtar është marrë përsipër, pavarësisht nga dispozitat kushtetuese”.

Përveç Serbisë dhe Kosovës, palë kontraktuese e marrëveshjes së normalizimit duhet të jetë edhe BE-ja, tha një ekspert nga Beogradi, por theksoi se një gjë e tillë është pothuajse e pamundur - “BE duhet t’u premtojë palëve diçka dhe më së miri do të ishte që të jetë pjesë e marrëveshjes”.

Marrëveshja e drejtpërdrejtë ndërmjet KOS-it dhe Qeverisë së Kosovës shihet si një skenar pothuajse i pamundur për shkak të marrëdhënieve aktuale të dëmtuara rëndë, por edhe për shkak të qëndrimit të vendosur të KOS-it për mosnjohjen e Kosovës dhe perceptimit shumë negativ të komunitetit shumicë në Kosovë drejt KOS-it.

4. Argumentet për dhe kundër përfshirjes së përfaqësuesve të kishës në bisedimet eventuale për statusin e KOS-it

Për DRP, argumentet për përfshirjen e statusit të saj në bisedime për normalizimin e marrëdhënieve janë të shumta. Përpjekja shumëvjeçare e Qeverisë së Kosovës për ndërtimin e rrugës ndërkombëtare tranzit përmes zonës së veçantë të mbrojtur rreth manastirit Deçan dhe shkelja e Ligjit për zonat e mbrojtura, i cili një aktivitet të tillë e ndalon në mënyrë eksplicite, janë ndërprerë pas përpjekjeve diplomatike të komunitetit ndërkombëtar¹⁰. Vendimi i instancave më të larta gjyqësore, duke përfshirë edhe Gjykatën Kushtetuese¹¹ lidhur me regjistrimin e pronës së Manastirit Deçan në kadastër nuk zbatohet tash më 6 vite, krahas paralajmërimeve të shumta¹² të bashkësisë ndërkombëtare

¹⁰ KoSsev, EU: U dakordua rruga Deçan -Plavë jashtë ZVM dhe rehabilitimi i rrugës lokale përbrenda ZVM 12. nëntor 2020: <https://kossev.info/eu-dogovorena-deonica-decani-plav-van-szz-i-rehabilitacija-lokalnog-puta-unutar-szz/>

¹¹ Gjykata kushtetuese e Kosovës, Vendimi për vazhdimin e masës së përkohshme në rastin KI 132/25, 12. shkurt 2015: https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/gjk_ki_132_15_vmp_srb.pdf

¹² N1, Kvinta: Qeveria e Kosovës që „pa shtyrje” ta regjistroj tokën e Deçanit në kadastër 19. maj 2021: <https://rs.n1info.com/vesti/kvinta-vlada-kosova-da-bez-odlaganja-upise-zemljiste-decana-u-katastar/>

lidhur me domosdoshmërinë e respektimit të vendimeve gjyqësore dhe sundimit të ligjit. Thirrja e Gjykatës kushtetuese¹³ për prokurorinë publike për ta filluar hetimin dhe të konstatojë kush është përgjegjës për moszbatimin e vendimit të plotfuqishëm të Gjykatës kushtetuese, deri më sot nuk ka pasur sukses. Paditë e vazhdueshme të Universitetit në Prishtinë për shkak të ndërtimit të Kishës - Krishti Shpëtimtar, e cila gjendet në afërsi të Kampusit janë hedhur poshtë për shkak të mosparaqitjes së ankuesit në shqyrtime kryesore¹⁴. Në anën tjetër, vendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, i konfirmuar nga Gjykata e Apelit¹⁵, se Kisha Ortodokse Serbe ka të drejtë të përdorë Kishën e Krishtit Shpëtimtar deri në vendimin përfundimtar për padinë e

¹³ Gjykata kushtetuese e Kosovës, Vendim për mosekzekutimin lidhur me vendimin e Gjykatës kushtetuese të Republikës së Kosovës, të datës 19. maj 2016. në rastin nr. KI 132/15, 24. shtator 2015: https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2021/09/ki132-15_VPM_srb.pdf

¹⁴ RTS, Vazhdon tregimi dhe kontestimi i tokës së KOS-it në Prishtinë, 3. shkurt 2022: <https://www.rts.rs/page/stories/ci/story/124/drustvo/4687196/spc-pristina-hrista-spasa.html>

¹⁵ Radio Evropa e lirë, Kishës Ortodokse serbe i takon toka në Prishtinë, 14. nëntor 2017: <https://www.slobodnaevropa.org/a/spc-univerzitet-pristina/28853536.html>

UP-së, është injoruar me reagime negative të zyrtarëve të Kosovës. Shkatërrimi i varrezave ortodokse dhe dëmtimi i objekteve fetare nuk has në dënimin publik nga zyrtarët kosovarë të komunitetit shumicë, ndërsa vetë kryeministri i Kosovës në një letër të hapur¹⁶ drejtuar përfaqësuesit e DRP-së refuzon të shënojë objektet e tyre sakrale si "Kisha Ortodokse Serbe".

"Ti je i padëshiruar, ti je objekt për shkatërrim; Porosia është e qartë, ne do të bëjmë çka të dëshirojmë, ndërsa ju duhet të përkuleni dhe të largoheni". Në këtë mënyrë qytetarë në fokus grupe e përmbledhin mënyrën si i shohin raportet DRP dhe Qeverisë së Kosovës, kur bëhet fjalë për mosrespektimin e vendimeve, por edhe mungesën e reagimeve me rastin e shkatërrimit të objekteve të shenjta dhe varrezave.¹⁷ Sa është e rëndësishme për përfaqësuesit e komunitetit serb në Kosovë KOS-i, përkatësisht DRP dhe kjo është e evidente që DRP është "institucioni më i rëndësishëm dhe vital", i cili gëzon "besimin më të madh të qytetarëve". Është meritore, siç besojnë, për ekzistencën e komunitetit serb në Luginën e Anamoravës së Kosovës dhe mjediset e tjera në Jug të Lumit Ibër dhe ka luajtur rolin kyç në periudhën e pasluftës kur shumë përfaqësues lokal serb dhe përfaqësuesit politik e braktisën Kosovën. - "në Kosovë mbetën vetëm DRP dhe qytetarët". Komuniteti serb në Kosovë, gjithashtu është i bindur se përfaqësuesit e kishës "në aspekt intelektual janë më superior në krahasim me mesataren e përfaqësuesve të atij komuniteti", kështu që "në botë janë të vlerësuar dhe kanë ndikim tek zyrtarët perëndimor", për çarsye besojnë që ata do t'i përfaqësojnë në mënyrë kualitative edhe interesat më të gjera të komunitetit serb në Kosovë, dhe jo vetëm interesat e grupit të fetar.

16 Publikimi në Fejsbuk, profili zyrtar Harulah Çeku, 26 maj 2021: <https://www.facebook.com/438860019957922/photos/a.438860343291223/1115709962272921/?type=3>

17 55% të anketuarve në sondazhin e opinionit publik të kryer në kuadër të Iniciativës Open për nevojat e këtij sondazhi, theksojnë se deklaratat e zyrtarëve kosovar dhe historianëve lidhur me trashëgiminë e KOS-it janë "armiçësore".

Roli i DRP-së në organizimin e komunitetit në vakumin institucional të pasluftës, por edhe përkushtimi i saj ndaj komunitetit serb në Kosovë gjatë "dekadës së ateizmit militant", gjatë komunizmit¹⁸ kur liritë fetare ishin edhe më të kërcënuara, burim kyç i qytetarëve është besimi, thotë historiani Petar Ristanovic. Ndërsa pati një valë të madhe të emigrimit të serbëve të Kosovës, nga vitet e gjashtëdhjeta deri në fund të tetëdhjetave emigruan rreth 40% për shkak të presionit dhe politikave të liderëve komunist krahinor, "tensionet ndëretnike në Kosovë ishin tabu" dhe "i vetmi Institucion që u përpoq tu ofroj njëfarë mbrojtje dhe paralajmërojë publikun për problemet e tyre ishte KOS-i".

Për zyrtarët e Kosovës, por edhe për opinionin e gjerë në Kosovë, insistimi i DRP për respektimin e Ligjit për zonat e mbrojtura është pengesë për zhvillim ekonomik¹⁹ të Komunës së Deçanit. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese për konfirmimin e pronësisë së Manastirit të Deçanit për mbi 24 ha tokë është: i padrejtë, ngase e "konfirmon vendimin e regjimit të Slobodan Milosheviqit"²⁰; ngase është nxjerr "nën presion e komunitetit ndërkombëtar"²¹; "është skandaloz", ngase rasti është vëzhguar "ndaras nga konteksti i tij politik-historik"²²; i zbatueshëm, por vetëm "në dialog dhe në marrëveshje me banorët lokal"²³.

18 Më shumë mbi rolin e KOS-it dhe DRP në kohën e komunizmit, lexoni në tekstin autorial të ndarë të historianit Petar Ristanovic, RTV Kim, "Më mirë të jemi këtu" – KOS në Kosovë e Metohi në kohën e komunizmit. <https://www.radiokim.net/vesti/analiza/spc-na-kosovu-za-vreme-kunizma-valja-nama-bitovde.html>

19 KoSSev, *Është hapur edhe një aks i rrugës Deçan – Plavë: Institucionet serbe paralajmërojnë shkeljen e Ligjit për zonat e veçanta të mbrojtura*, 18. qershor 2020: <https://kossev.info/otvorena-jos-jedna-deonica-puta-decani-plav-srpske-institucije-upozoravaju-na-kršenje-zakona-o-specijalnim-zastitnim-zonama/>

20 KoSSev, *Për kthimin e tokës Manastirit të Deçanit: "Vendimin e turpshëm" nuk do ta zbatojmë: Thaqi, Delavi dhe Rakić përshëndesin vendimin e Gjykatës Kushtetuese* 21. maj 2016: <https://kossev.info/o-vracanju-zemlje-visokim-decanima-sramnu-odluku-necemo-sprovesti-taci-delavi-i-rakic-pozdravljanju-odluku-ustavnog-suda/>

21 Radio Evropa e lirë, *Manastiri Deçan në labirint juridik* . 2. nëntor 2021: <https://www.slobodnaevropa.org/a/kosovo-manastir-visoki-decani-zemljiste-sud/31541871.html>

22 KoSSev, *Konjufca: Vendimi mbi tokën e M.Deçan nuk duhet të zbatohet, gjyqtarët nuk e kanë mbrojtur Kushtetutën e Kosovës*, 16.dhjetor 2021: <https://kossev.info/konjufca-odluku-o-zemlji-v-decana-ne-treba-sprovesti-sudije-nisu-stitile-kosovski-ustav/>

23 KoSSev, *Kurti për Deçanin: Do të përpiqemi që t'i ruajmë të*

Këtë qëndrim ndaj KOS-it dhe DRP-së si pjesa më e dukshme e saj në Kosovë, i anketuari shqiptar e ka shpjeguar me bindjen e popullatës shumicë në Kosovë se KOS-i nuk është "institucion që merret me mbrojtjen e trashëgimisë fetare, por institucion politik" dhe se është një "iniciativë shtetërore, qëllimi i të cilës është të mbajë gjallë mitin e Kosovës». Kisha Ortodokse Serbe dhe përfaqësuesit e saj shpesh akuzohen për krime lufte²⁴ në mediat kosovare dhe fotot e krerëve të kishës me drejtues të njëjsteve ushtarake dhe paraushtarake serbe janë bashkangjitur për të mbështetur këto pretendime. Para bisedimeve për respektimin e të drejtave të Kishës Ortodokse Serbe, është e nevojshme që ajo të depolitizohet, dhe përfshirja e saj në negociatat ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës po bën pikërisht këtë - kjo dëshmon se Kisha Ortodokse Serbe është një organizatë politike, thekson bashkëbiseduesi.

Për përfaqësuesit e shqiptarëve të Kosovës, çdo hapje e çështjeve të rregulluara me Planin e Ahtisaarit është e papranueshme, ndërsa Kisha Ortodokse Serbe i frikësohet një situatë të tillë, por ka indikacione se edhe disa dispozita të Aneksit V mund të hiqen nga legjislacioni i Kosovës dhe kërkojnë garanci ndërkombëtare.

Për ekspertët nga Serbia, përfshirja e çështjes së KOS-it në dialogun ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës është e nevojshme - "Nuk mund ta imagjinoj që kjo të mos ndodhë". Ata besojnë se kjo do të kontribuonte për një marrëveshje më të lehtë dhe se do të "kontribuonte në kompensimin e disa temave të tjera të vështira". Mirëpo, shumë besojnë se kjo nuk është e mundur me qeverinë e Albin Kurtit, e cila "dialogun nuk e kupton si diçka që i duhet dhe për këtë arsye vjen në negociata me ide maksimaliste".

drejtat legjitime të Manastirit, por edhe krerët fetar duhet ta bëjnë punën e tyre, 5 shkurt 2022: <https://kossev.info/kurti-o-v-de-canima-potrudicemo-se-da-sacuvamo-legitimna-prava-manastira-ali-i-verski-poglavari-da-urade-svoj-deo-posla/>

²⁴ Danas, Këshilli për mbrojtjen e të drejtave të njeriut nga Prishtina kërkon hetime kundër igumenit Sava Janjić „për krime lufte”, 11 prill 2021: <https://www.danas.rs/vesti/politika/savet-za-zastitu-ljudskih-prava-iz-pristine-trazi-istragu-protiv-igumana-save-janjica-zbog-ratnih-zlocina/>



Ti je i padëshiruar, ti je objekt për shkatërrim; Porosia është e qartë, ne do të bëjmë çka të dëshirojmë, ndërsa ju duhet të përkuleni dhe të largoheni". Në këtë mënyrë qytetarë në fokus grupe e përmbledhin mënyrën si i shohin raportet DRP dhe Qeverisë së Kosovës, kur bëhet fjalë për mosrespektimin e vendimeve, por edhe mungesën e reagimeve me rastin e shkatërrimit të objekteve të shenjta dhe varrezave.



Për përfaqësuesit e shqiptarëve të Kosovës, çdo hapje e çështjeve të rregulluara me Planin e Ahtisaarit është e papranueshme, ndërsa Kisha Ortodokse Serbe i frikësohet një situatë të tillë, por ka indikacione se edhe disa dispozita të Aneksit V mund të hiqen nga legjislacioni i Kosovës dhe kërkojnë garanci ndërkombëtare.

Opsioni 1: Përfshirja direkte e përfaqësuesve të KOS-it në dialogun në mes të Beogradit dhe Prishtinës

Qytetarët e komunitetit serb në Kosovë pjesëmarrës në fokus grupe por edhe të intervistuar janë të vetmit që janë afër këtij opsioni, megjithëse besojnë se nuk ka gjasa - "askush nga bashkësia ndërkombëtare nuk do të lejojë ndërhyrjen e KOS-it në politikën e Kosovës, pas ngjarjeve në Mal të Zi".

Mendim të ngjashëm ka edhe një nga përfaqësuesit politikë të komunitetit serb në Kosovë, i cili thekson se, ndryshe nga periudha menjëherë pas luftës, kur komuniteti serb praktikisht mbeti pa përfaqësues politikë dhe kur bashkësia ndërkombëtare dhe përfaqësuesit shqiptarë të Kosovës, pa diskutim u angazhuan në Bisedimet e drejtpërdrejta me përfaqësuesit e DRP-së, serbët e Kosovës tani kanë përfaqësues politikë dhe një ndërhyrje e tillë e KOS-it nuk do të ishte e pranueshme. Mirëpo, ky bashkëbisedues kujton se përfaqësuesit e DRP-së ishin përgjegjës për "institucionalizimin e përkohshëm të komunitetit serb", se shkrimi i Këshillit Kombëtar Serb të Kosovës dhe Metohisë nga Veriu dhe Graçanica ishte kyçe, se ata ishin pjesë e këshillave lokale për kthim në komuna, morën pjesë në negociata, si në konferencën në Uashington, por edhe në takime dhe iniciativa të tjera në Kosovë. Përfaqësuesit e Kishës Ortodokse Serbe, në periudhën e pasluftës, gjithashtu morën pjesë në diskutim për të gjitha temat, jo vetëm ato që kanë të bëjnë me Kishën Ortodokse Serbe - si siguria, kthimi, liria e lëvizjes, madje edhe për drejtën për informim të komunitetit serb në Kosovë, thekson ky bashkëbisedues.

Për bashkëbiseduesin nga komuniteti shqiptar, vetëm paralajmërimi për mundësinë e hapjes së statusit të Kishës Ortodokse Serbe në negociata "do të shkaktonte një valë reagimesh negative, po aq të fuqishme sa edhe reagimet ndaj Asociacionit të Komunave Serbe". Ai shtoi se çdo diskutim i mëtutjeshëm për të drejtat, para se Serbia ta njohë Kosovën, është i pamundur, sepse kjo, si temat tjera që kanë të bëjnë me komunitetin serb në Kosovë, për përfaqësuesit politikë në Kosovë, por edhe komunitetin e gjerë "përfundon me Planin e Ahtisarit". "Të gjithë do të rezistojnë të bisedojnë me komunitetin serb derisa ta njohin Kosovën".

Sipas bashkëbiseduesve nga komuniteti serb në Kosovë, por edhe ekspertëve nga Beogradi, Beogradi nuk do të ishte i kënaqur me përfshirjen e drejtpërdrejtë të Kishës Ortodokse Serbe në negociata. Ndërsa mbështetja e kishës është e një rëndësie kyçe për qeverinë serbe, ata "megjithatë nuk do të donin që dikë që mendon me kokë të vetë dhe të cilit nuk mund t'i imponoj qëndrime" të ndërhyjë në procesin afatgjatë. "As kisha nuk do të pajtohej me këtë, sepse kjo do të nënkuptonte marrjen e përgjegjësisë për të gjithë marrëveshjen, duke përfshirë edhe pjesën që mund të duket si njohje". Edhe pse, sipas disa mendimeve kjo nuk është reale, ky opsion do t'i mundësonte "kishës të qetësonte opinionin publik në rast të një zgjidhjeje të diskutueshme dhe vetëm nëse kisha arrin të maksimizojë përfitimet e dialogut në dobi të saj".

Opsioni 2: Përfshirja indirekte e përfaqësuesve të KOS-it në dialog në mes të Beogradit dhe Prishtinës

Kjo mënyrë e përfshirjes së përfaqësuesve të KOS-it në bisedime është më e pranueshme për përfaqësuesit e DRP, ndërsa anëtarët e grupeve të ndryshme e konsiderojnë si të mundshme, me parakushte të caktuara.

“Ata kanë nevojë për një sistem shumë më kompleks të mbrojtjes së të drejtave, nuk bëhet fjalë për politikë por për mbijetesë të kishës dhe popullit”, tha një burim pranë KOS-it, duke shtuar se “në kushtet aktuale” edhe DRP vazhdimisht ka theksuar nevojën për ngritjen e çështjes së pronës dhe statusit të Kishës Ortodokse Serbe, si pjesë e dialogut, por nuk janë shprehur publikisht se si i shohin aspektet teknike të këtyre negociatave. Ndërkaq, bashkëbiseduesi nga këto qarqe zgjidhjen e sheh në modelin që është aplikuar me ekipin e Marti Ahtisaarit - “pastaj janë zhvilluar bisedime të drejtpërdrejta me ekipin e Marti Ahtisaarit, i cili kështu është njohur me situatën dhe në bazë të këtyre kontakteve kryesisht është hartuar Kapitulli V”. Nga ana tjetër, Patriarkana, peshkopi kompetent dhe ekspertët ishin pjesë e ekipit negociator i Beogradit, ndaj do të ishte e paimagjinueshme edhe tani që të mos kishte asnjë koordinim ndërmjet tyre - “është logjikshme që kisha të japë propozimet e saj si në vitin 2008. dhe mendoj se shteti tashmë është mjaft i informuar për modalitetet e ndryshme të zgjidhjes”.

Për bashkëbiseduesit nga qarqet e ekspertëve në Serbi, ky lloj i përfshirjes së përfaqësuesve të KOS-it në dialog është gjithashtu më i përshtatshmi. Nga njëra anë, ata besojnë se përfshirja e tyre direkte në një proces të ndërlikuar që zgjat më shumë se një dekadë është e pamundur, ndërsa nga ana tjetër, fakti që “Daçiq ka harruar të përmendë KOS-in në vitin 2013”, është dëshmi se shteti nuk respekton, siç duhet interesat KOS-it. Ata shtojnë se rasti i idesë së demarkacionit dhe rrënimit të plotë të saj, pas reagimit të përfaqësuesve të kishës, është një shenjë e qartë se “Kisha Ortodokse Serbe, si një nga aktorët kryesorë të normalizimit, nuk mund të pacifikohet dhe të nënvlerësohet”.

Bashkëbiseduesit që ndjekin nga afër Kishën Ortodokse Serbe, në këtë skenar shohin probleme të mundshme në vetë hierarkinë kishtare. Ata theksojnë rolin dominues të Patrikanës në të gjitha çështjet e kishës dhe theksojnë se kjo mund të çojë në majorizim të përfaqësuesve dhe ekspertëve të DRP, që e kuptojnë më mirë situatën në terren - «përfaqësuesit e DRP nga demarkacioni nuk guxojnë publikisht të flasin, “ thotë një bashkëbiseduese. Pikërisht pjesëmarrja e përfaqësuesve të DRP-së do t'i jepte një vullë kredibiliteti marrëveshjes sepse, “ndonëse publiku në Serbi e respekton Kishën Ortodokse Serbe, DRP dhe Mitropolia e Malit të Zi konsiderohen se janë shumë më të mishëruar me popullin sesa dioqezat dhe mitropolitanet e tjera”, shtoi ajo.

Opsioni 3: Përjashtimi i plotë i temës së KOS-it nga marrëveshja për normalizimin e marrëdhënieve

Ky opsion është më i përafërt dhe më i pritshëm për përfaqësuesit e komunitetit shqiptar në Kosovë. Qeveritarët dhe bashkëbiseduesit theksojnë se një marrëveshje gjithëpërfshirëse për normalizimin e marrëdhënieve duhet të synojë "njohjen reciproke". Vetëm pas njohjes mund të vijojë një dialog i brendshëm, në kuadër të të cilit do të mund të hapeshin disa çështje të mbrojtjes së të drejtave të komunitetit serb në Kosovë, por edhe KOS-it – "çdo bisedë për KOS-in para njohjes është e pamundur".

Në thelb të "paranojës" së autoriteteve kosovare është mosbesimi, sipas një bashkëbiseduesi nga komuniteti shqiptar i Kosovës. Në Kosovë "është i përhapur mendimi se pala kosovare ka bërë mjaft kompromise, duke filluar me pranimin e Planit të Ahtisarit". Ngjashëm me palën serbe, e cila thotë se nuk janë përfshirë të gjitha dispozitat e Aneksit V në legjislacionin e Kosovës. Njëri nga të anketuarit thekson se "pjesë e Aneksit V ishte kthimi i eksponateve arkeologjike dhe etnografike, vetëm përparimi në këtë kuptim do të kishte do të vendoste disa themele për ndërtimin e besimit. Kështu duket sikur Kisha Ortodokse Serbe ka fituar gjithçka dhe nuk ka ekuilibër në koncesione".

Për dallim nga delegacioni i Kosovës, pala serbe asnjëherë nuk e pranoi planin e Ahtisarit²⁵

²⁵ Derisa në publik nuk kishte vërejtje të mëdha lidhur me pozitën e komunitetit serb, për Beogradin zyrtar të atëhershëm, ishte politikisht e papranueshme dispozita që ka të bëjë me "pavarësinë e mbikëqyrur". "Ahtisari ka përmbledhur atë që Serbët me vite kanë kërkuar", theksoi përfaqësuesi politik i Serbëve të Kosovës.

dhe kjo dispozitë për Beogradin nuk hyri kurrë në fuqi. Megjithatë, pikërisht ky fakt është shpesh një burim pakënaqësie dhe kritikash për palën kosovare, zyrtarët e së cilës janë të pakënaqur me thirrjet e shpeshta të DRP-së në dispozitat e Ahtisaarit dhe pavarësinë e njëkohshme të Kosovës të shpallur në bazë të dokumentit.

Përfaqësuesit e DRP përgjigjen se nuk janë subjekt politik dhe se nuk u takon të pranojnë diçka apo jo. Ata konsiderojnë se i takon qeverisë së Kosovës t'i respektojë ligjet dhe detyrimet e veta, veçanërisht ato që dalin nga kompromisi me komunitetin ndërkombëtar, me qëllim të njohjes së pavarësisë.²⁶

Qytetarët në fokus grupe nuk e shohin si të favorshëm një rezultat në të cilin nuk ka negociata, por nuk e përjashtojnë. Disa madje besojnë se Kosova me qeverinë aktuale në krye nuk mund të arrijë një marrëveshje për çfarëdo çështje - "asnjë marrëveshje politike midis Beogradit dhe Prishtinës nuk është e mundur për momentin, komuniteti serb dhe ai shqiptar mund të vendosin lidhje vetëm përmes bashkëpunimit ekonomik," u theksua në një nga fokus grupet. Me tone të ngjashme flasin edhe ekspertët nga Serbia, të cilët pohojnë se "në skenën politike të Kosovës është një situatë e ngurtë kush do të jetë më i ashpër, prandaj në këtë atmosferë arritja e marrëveshjes dhe iniciimi i temës së KOS-it janë të pasigurta.

²⁶ Kosovo Online, *Iguman Janjić: Vendimi për rrugën Deçan – Plavë duhet të jetë në kuadër të ligjit*. 18. gusht 2020: <https://www.kosovo-online.com/intervjui/iguman-janjić-resenje-za-put-decani-plav-treba-da-bude-u-okviru-zakona-18-8-2020>

5. Përfundim

Si organizata më e besuar dhe e parë nga qytetarët si përfaqësuesja më legjitime, në një pjesëmarrje potenciale në negociatat për normalizimin e plotë të marrëdhënieve në mes të Prishtinës dhe Beogradit, KOS-i dhe DRP, do ndihmonin në bërjen e një marrëveshje të tillë më të pranueshme për komunitetin serb. Përfaqësuesit politikë zyrtarë të serbëve në Kosovë janë parë disa herë në të kaluarën e afërt si jo të përgatitur në situata krize, jo të bashkuar, jo të pavarur, por edhe të tjetërsuar nga komuniteti²⁷, prandaj garancitë e tyre për një marrëveshje të mundshme nuk kanë peshë të mjaftueshme. Megjithatë, reputacioni i Kishës Ortodokse Serbe në opinionin kosovar mund të kontribuojë në idenë e përfshirjes së përfaqësuesve të saj në negociata, duke krijuar në ndonjë mënyrë pengesë të re të pakapërcyeshme në negociata, të ngjashme me përmasat e Asociacionit të Komunave Serbe, e cila tash më 9 vite i ngarkon negociatat.

Refuzimi i negociatave që përfshijnë përfaqësues të KOS-it do të nënkuptonte për ekspertët serbë "që do të thotë se përfaqësuesit shqiptarë nuk kanë respekt për lirinë fetare", një pretendim që anëtarët e komunitetit serb në Kosovë tthonë se nuk ka nevojë të dëshmohet.²⁸

²⁷ Iniciativa e re sociale, *Partitë politike të Serbëve të Kosovës në sistemin politik të Kosovës: Nga pluralizmi deri në monizëm 2021*: <http://newsocialinitiative.org/wp-content/uploads/2021/05/11-Partite-Politike-SRB-02.pdf>

²⁸ Gati 70% të anketuar në hulumtimin e opinionit publik, të bazuar në kuadër të iniciativës Open, ndërsa për nevojat e këtij hulumtimi nuk përputhet me pohimin e një zyrtari kosovar që „Kosova është shembull i tolerancës nder fetarë dhe bashkëjetesës”.

Duke qenë se dialogu nuk jep përgjigje as për pyetjet teknike për më shumë se një vit, është e vështirë të imagjinohet se ka kushte për të hapur çështjet e identitetit brenda saj. Nga ana tjetër, pa garanci të forta për çështjet e identitetit me në qendër Kishën Ortodokse Serbe, është e pamundur të imagjinohet një marrëveshje e pranueshme për publikun Serb. Përfundimisht, vula e miratimit të KOS-it për një marrëveshje që nënkupton njohje ose është e pranueshme për popullin e Kosovës është pothuajse e pamundur të merret. Këto rrethana e vendosin Kishën Ortodokse Serbe në rolin e një krijuesi të mundshëm, por edhe një shkatërrues të mundshëm të marrëveshjes Beograd-Prishtinë, por pavarësisht se si e përdor Kisha Ortodokse Serbe ndikimin e saj, ajo është një aktor që nuk mund të anashkalohet.

Iniciativa Open është e përkrahur nga KFOS

